




**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE**

# **PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 24-36 MUAJSH**

## **MUAJI MAJ**



**PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS**

## Çfarë duhet të dimë për muajin Maj?



- ❖ *Muaji Maj është muaji i tretë i stinës së pranverës.*
- ❖ *Muaji Maj është muaji i buzëqeshjeve.*
- ❖ *Muaji Maj është muaji i biçikletave.*
- ❖ *Muaji Maj është muaji i fotografisë.*
- ❖ *Muaji Maj është muaji i luleshtrydhes.*
- ❖ *Në muajin Maj çelin luleboret, trëndafilat dhe tulipanët.*

## Muaji Maj- Tema: Sportet dhe lojërat

Grupi: 24-36 muajsh



- \* **Java I:** Sportet: futbolla, basketbolla, volejbolla dhe tenisi
- \* **Java II:** Lojërat me ngjyrat
- \* **Java III:** Lojërat me numrat
- \* **Java IV:** Programi për 1 Qershorin

---



### Tema mujore: Sportet dhe lojërat




Temat Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Njohja me sportet.	Fëmijët gjatë kësaj jave do të njihen me disa prej sporteve, si: futbolla, volejbolla, tenisi, basketbolla.	Java I
Lojërat me ngjyrat	Të njohim ngjyrat përmes artit dhe lojës.	Java II
Lojërat me numrat	Të njohim numrat përmes aktiviteteve dhe lojërave.	Java III
Programi për 1 Qershorin	Argëtohemi dhe përgatitemi për të festuar.	Java IV





**Shënim:**

- \* Stafi edukator duhet ta realizojë sa më qartë shpjegimin dhe realizimin e aktiviteteve me qëllim asimilimin sa më thjeshtë të njohurive nga fëmijët.
- \* Stafi edukator duhet të informojë prindërit mbi tematikën mujore/javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi.

**Tema mujore: Sportet dhe lojërat****Tema e javës: Sportet: futboli, basketbolli, volejboli dhe tenisi**

<b>Java I</b>	<b>Rubrika</b>	<b>Aktivitetet</b>	<b>Mjetet e Punës</b>
<b>E Hënë</b>	Sporti dhe rëndësia e tij  Loja e futbollit	<p><b>Aktivitet fizik:</b> Fëmijët imitojnë ushtrimet gjimnastikore.</p> <p><b>Bisedë edukatore-fëmijë:</b> Edukatorja iu flet fëmijëve për sportet dhe rëndësinë e tyre për shëndetin p.sh.:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Sportet forcojnë trupin dhe muskujt.</li> <li>✓ Sportet na ndihmojnë të mësojmë, të luajmë në grup.</li> </ul> <p>Edukatorja pyet fëmijët: Çfarë sportesh njihni ju? A luajnë ata në shtëpi me top? Çfarë ngjyre ka topi juaj? Edukatorja u tregon fëmijëve foto të sporteve të ndryshme, llojet e topave dhe emërton ngjyrat e tyre.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Topi im”.</p> <p><b>Përralla:</b> “Ndeshje në fushë të gjelbër”.</p> <p><b>Punë me ngjitje:</b> Me letër të bardhë ose pjata plastike krijoni një rreth dhe kërkoni fëmijëve të ngjisin në të trapezat e prera më parë nga edukatorja duke formuar topin e futbollit ( si në fig.)</p> <p><b>Loja:</b> Pasimi i topit me këmbë, loja energjike (loja sugjerohet të zhvillohen në oborr).</p>	<p>Mjete Didaktike: fletë a4 të bardha/ pjata plastike, ngjitës, letra me ngjyra.</p> <p>Libri “365 rrëfenja para gjumit”.</p> 

<p><b>E Martë</b></p>	<p>Loja e voleybollit</p> 	<p><b>Bisedë edukatore-fëmijë:</b> Edukatorja u tregon fëmijëve përmes fotove ose duke improvizuar në grup se si luhet loja e voleybollit, duke emërtuar edhe elementët e saj si: rrjeta, topat, veshjet etj.</p> <p><b>Aktivitet: Kubi i aktivitetit fizik.</b> Edukatorja përmes një kutie ose me karton krijon një kub në faqet e të cilit shënon nga një aktivitet fizik (p.sh. duart lartë, hidhu, vrapo, përplas duart si zog etj). Fëmija hedh kubin dhe kryen aktivitetin që i bie.</p> <p><b>Loja e voleybollit:</b> Loja zhvillohet në oborr dhe edukatorja i ndihmon fëmijët ti pasojnë/presin topin me duar njëri-tjetrit.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Topi im” (mësimi i koncepteve lartë-poshtë).</p>	<p>Mjete Didaktike: karton/kuti, plasteline etj. Manuali i Vjershave</p> 
<p><b>E Mërkurë</b></p>	<p>Loja e tenisit</p> 	<p><b>Bisedë edukatore-fëmijë:</b> Edukatorja pyet fëmijët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>❖ A keni luajtur ndonjëherë tenis?</li> <li>❖ A i keni parë fushat e tenisit në parkun e liqenit?</li> </ul> <p>Ajo u tregon fëmijëve përmes fotove ose duke improvizuar në grup se si luhet loja e tenisit, duke treguar dhe elementët e saj si: raketat, topat, veshjet etj.</p> <p><b>Loja:</b> “Të luajmë tenis me tullumbace”. (Vendosini fëmijët dy e nga dy përballë njëri tjetrit, jepini atyre nga një raketë tenisi (nëse nuk disponohen raketa, përdoren pjatat plastike/karton në vend të raketës). Jepini fëmijës nga një tullumbac, lërinë të lirë të zgjedhin ngjyrën që ata dëshirojnë. Ndihmojini fëmijët të gjuajnë tullumbacin me raketë).</p> <p><b>Vjersha</b> “Balona”.</p> <p><b>Punë dore:</b> <i>Krijimi i raketës së tenisit me makarona ose oriz.</i> (Në një flet ose me karton vizatoni një raketë tenisi dhe kërkojuni fëmijëve të ngjisin brenda saj kokrat e orizit ose makarona.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: Tullumbace, karton, makarona, oriz, ngjitës etj.</p>





<p><b>E Enjte</b></p>	<p>Loja e basketbollit</p> 	<p><b>Bisedë edukatore-fëmijë:</b> Edukatorja u tregon fëmijëve përmes fotove ose duke improvizuar në grup se si luhet loja e basketbollit, duke treguar koshin, topin e basketbollit, veshjet e lojtarëve etj.</p> <p><b>Loja:</b> Hedhim topin në koshat e basketbollit. Loja zhvillohet në ambjentin e grupit dhe edukatorja ndihmon fëmijët të respektojnë rradhën me njëri-tjetrin.</p> <p><b>Aktivitet:</b> <i>Mini basketboll</i>, fiksoni me ngjitës 5 gota plastike me ngjyra të ndryhme në një tabel ose karton, kërkojuni fëmijëve të hedhin topat në gota sipas ngjyrës. (përkimi i ngjyrave)</p> <p><b>Vjersha:</b> “Topi im”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjetet Didaktike. Gota plastike, topa me ngjyra, kosh etj.</p> 
<p><b>E Premte</b></p>	<p>Dita e buzëqeshjes</p> 	<p><b>Vjersha:</b> “Më gëzon në Maj ti mua”.</p> <p><b>Bisedë: edukatore-fëmijë:</b> Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se muaji Maj është muaji i buzëqeshjeve. Edukatorja pyet fëmijët : - A jeni të lumtur sot? Çfarë ju bën të lumtur? Ajo u tregon sesi ndjehemi ne kur buzëqeshim duke ftuar fëmijët të imitojnë me mimikë një buzëqeshje.</p> <p><b>Aktivitet:</b> Fëmijët mësojmë të vizatojnë fytyrën e buzëqeshur ne letër ose duke përdorur tullumbace. Pas vizatimit ata e ngjyrosin fytyrën me ngjyrën sipas dëshirës ose luajnë me tullumbacet.</p> <p><b>Aktivitet.</b> Muzikë dhe kërcim.</p>	<p>Mjete didaktike: letra dhe lapsa me ngjyra.</p> <p>Mjete Didaktike: plastelinë, mbështjellëse/letra për kekë, shkopinj druri, fletë me ngjyra.</p> 







Tema mujore: Sportet dhe lojërat



Tema e javës: Njohja me ngjyrat





Java II	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Ngjyra e kuqe 	<p><b>Vjersha:</b> “Qershia.”</p> <p><b>Bisedë edukatore-fëmijë:</b> Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën e kuqe dhe se ku e gjejmë atë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>✓ Në natyrë, tek bimët, lulet, pemët,</li><li>✓ Tek insektet/gjallesat, si p.sh: nusepashka, gaforrja etj.</li><li>✓ Tek frutat dhe perimet: mollët, qershitë, luleshtrydhet, domatet,specet etj.</li></ul> <p><b>Aktivitet:</b> Edukatorja u tregon fëmijëve objekte të ndryshëm dhe i pyet ata nëse kanë ose jo ngjyrë të kuqe. Ajo i ndihmonë fëmijët të identifikojnë sendet me ngjyrë të kuqe që ndodhen në çerdhe.</p> <p><b>Punë dore:</b> Krijimi i gaforres së detit. Edukatorët mund të përdorin ilustrimin e këtij materiali.</p> <p><b>Aktivitet:</b> Përkimi i ngjyrave të ngjashme. (edukatorja mund të përdor një nga modelet e paraqitura në figur.</p> <p><b>Përrallë e lirë.</b></p>	<p>Mjete Didaktike: karton A3/mbështjellëse keku, letra me ngjyrë të kuqe/rozë, lapsa me ngjyra.</p>   



<p><b>E Martë</b></p>	<p>Ngjyra e gjelbër</p> 	<p><b>Vjersha:</b> “Ngjyrat e ylberit”.</p> <p><b>Lojë energjike:</b> me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja, etj. (Lojërat zhvillohen në oborr.)</p> <p><b>Bisedë edukatore-fëmijë:</b> Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën e gjelbër dhe ku e gjejmë atë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Në natyrë, tek pemët, bari, gjethet,</li> <li>✓ Tek kafshët: bretkosa, breshka etj,</li> <li>✓ Tek frutat dhe perimet: dardha, molla, rrushi, speci, kastravec, brokoli.</li> </ul> <p>Edukatorja i ndihmon fëmijët të mbledhin dhe tregojnë objektet me ngjyrë të gjelbër që ndodhen në oborrin e çerdhes.</p> <p><b>Punë dore:</b> <i>Krijojmë bretkosën ose gjarprin me pjata plastike. Vendosni në fytyrën e bretkosës shprehi të ndryshme emocionale, p.sh. i mërzitur, i lumtur, i habitur dhe pyetini fëmijët, p.sh. Cila prej bretkosave është e lumtur? Edukatorja pyet fëmijët se: Çfarë ngjyre ka bretkosa/gjarpri? Si bën ai/ajo? Ku jetojnë bretkosat/gjarprinjtë? etj.</i></p>	<p>Mjete Didaktike: plastelinë, pjata plastike.</p> 
<p><b>E Mërkurë</b></p>	<p>Ngjyra blu</p> 	<p><b>Bisedë edukatore-fëmijë:</b> Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën blu dhe se ku e gjejmë atë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Ngjyra e detit, disa peshqeve</li> <li>✓ Ngjyra e qiellit.</li> </ul> <p>Edukatoria ndihmon fëmijët të identifikojnë objektet/veshjet me ngjyrë blu që ndodhen përreth tyre ose në libra apo tablo.</p> <p><b>Aktivitet me tullumbace:</b> Fëmijët me ndihmën e edukatores fryjnë tullumbace blu, të kaltra dhe luajnë me to. Aktiviteti zhvillohet në oborr. (Mund të mbështillni një rreth me ngjitës dhe tu kërkonti fëmijëve të ngjitin në të tullumbacet ose topa me ngjyra, si në fig).</p> <p><b>Vjersha:</b> “Dola vizaton”.</p>	<p>Manuali i Vjershave</p> <p>Mjete Didaktike: plastelinë, kopsa, tullumbace, ngjitës etj.</p> 

		<p><b>Punë dore me plastelinë:</b> “Krijimi i peshkut blu”.</p>	
<p><b>E Enjte</b></p>	<p>Ngjyra e verdhë</p> <p>Krijojmë me punë dore lulediellin/bletën</p> 	<p><b>Vjersha:</b> “Ngjyrat e ylberit”.</p> <p><b>Bisedë edukatore-fëmijë:</b> Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën e verdhë dhe se ku e gjejmë atë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Në natyrë, tek lulet si: luledielli.</li> <li>✓ Tek shpendët/insektet, si bleta, zogu i verdhë etj</li> <li>✓ Tek frutat/perimet, si p.sh. pjepri, speci, kungulli, banania, limoni.</li> </ul> <p>Edukatorja ndihmon fëmijët të identifikojnë dhe emërtojnë sendet me ngjyrë të verdhë që ndodhen në çerdhe.</p> <p><b>Lojë: Kubi i ngjyrave dhe aktiviteteve:</b> Përmes kutive ose kartonave krijojnë një kub ku faqet e tyre të kenë ngjyrat e kuqe, gjelbër, blu, verdhë, portokalli. Për secilën ngjyrë përcaktoni nga një aktivitet fizik. Vendosni në tokë rathë që përkojnë me ngjyrën e faqeve të kubit. Kërkojini fëmijës të shkojë brenda rrethit që përkon me ngjyrën që i ra dhe të zhvillojë aktivitetin.</p> <p><b>Punë dore/ngjyrosje:</b> Fëmijët krijojnë me punë dore/ngjyrosin lulediellin/bletën. Edukatorët mund të përdorin ilustrimet në këtë material për ngjyrosje.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Semafori”</p>	<p>Manuali i Vjershave</p> <p>Mjete Didaktike: lapsa me ngjyra, plastelinë, fletë të bardha A4.</p> 






<p><b>E Premte</b></p>	<p>Përsëritje e ngjyrave Krijojmë ylberin me plastelinë</p> 	<p><b>Bisedë edukatore-fëmijë:</b> Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrat që mësuam gjatë javës (blu, e kuqe, e verdhë, e gjelbër) dhe përsërit së bashku me fëmijët se ku i gjejmë ato: në natyrë, tek bimët, lulet, kafshët, frutat dhe perimet etj.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Ngjyrat e ylberit”.</p> <p><b>Loja: Koni i ngjyrave.</b> Me pjata plastike krijoni rathë me ngjyra të ndryshme si në figurë. Kërkojuni fëmijëve që të hedhin rathët në tub sipas ngjyrës së përcaktuar më parë nga ju (respektojmë radhën, njohim ngjyrat).</p> <p><b>Punë dore me plastelinë:</b> Krijimi i ylberit.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: plastelinë/lapsa, fletë</p>  <p>A4, pjata plastike, tuba pecetash etj.</p>
------------------------	---	---	---

**Tema mujore: Sportet dhe lojërat**

**Tema e javës: Lojërat me numrat.**



Java III	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
<p><b>E Hënë</b></p>	<p>Përsërisim numrat 1-5</p>	<p><b>Loja. Treni (unë jam lokomotiva).</b></p> <p><b>Përsërisim numrat:</b> Përsëritja e numrave 1-5. Edukatorja ndihmon fëmijët të përsërisin numrat 1-5 duke përdorur 5 shqisat e njeriut (1 hundë/gojë, 2 sy/veshë, 4 gjymtyrë: 2 këmbë/2 duar dhe 5 gishta).</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike, kuti, kartona etj.</p>




		<p><b>Kënga:</b> ‘Një Elefant po kolovitet’  <b>Aktivitet:</b> <i>Kubi i aktivitetit fizik</i> (edukatorja përmes një kutie ose me karton krijon një kub në faqet e të cilit përcakton një aktivitet dhe sa herë do të bëhet ai (p.sh. duart lart 5 herë, hidhu 2 herë, vrapo 3 herë etj). Fëmija hedh kubin dhe kryen aktivitetin që i bie.  <b>Vjersha:</b> “Numrat”.</p>	
<p><b>E Martë</b></p>	<p>Mësojmë numrat 1-5</p> 	<p><b>Lojë energjike:</b> Me lëvizje ritmike të udhëhequr nga edukatorja etj. Lojërat zhvillohen në oborr.  <b>Vjersha:</b> “Numrat”.  <b>Punë dore:</b> Krijimi i krimbit ose breshkës me numra. Ngjitja e numrave tek krimbi ose te guacka e breshkës. Fëmijët, me ndihmën e edukatores, ngjisin numrat sipas renditjes në fletën e vizatuar. Pas renditjes, së bashku me edukatoren, fëmijët emërtojnë dhe ngjyrat.  <b>Përralla:</b> Lepuri dhe breshka.</p>	<p>Mjete Didaktike: fletë me ngjyra, gërshërë, ngjitëse, fletë A4, lapsa me ngjyra.</p> 
<p><b>E Mërkurë</b></p>	<p>Mësojmë numra 6-10</p> 	<p><b>Vjersha:</b> “Më gëzon në Maj ti mua”.  <b>Lojë energjike:</b> Me shami, me top, etj. Lojërat zhvillohen në oborr.  <b>Punë dore:</b> <i>Numërojme shinat e trenit</i>, përmes tubave të letrave higjienike ose shkopinjeve krijoni idenë e shinave të trenit me ngjyra të ndryshme, Lejojini fëmijët të ngjisin në to numrat nga 6-10 të krijuar më pare nga ju.  <b>Lojë ekuilibri dhe me shami:</b> Vizatoni disa vija të lakuara me forma të ndryshme në dysHEME ose oborr. Kërkojuni fëmijëve që të ecin sipas drejtimit të vijës dhe të kapin shaminë.  <b>Vjersha:</b> “Numrat”.</p>	<p>Manuali i Vjershave</p> <p>Manuali , ngjyra, letra A4, tupa letrash higjieni ose shkopinj.</p> 

<b>E Enjte</b>	<p>Mësojmë të radhisim</p> 	<p><b>Vjersha:</b> “Numrat”.</p> <p><b>Punë dore:</b> Fëmijët në bashkëpunim me edukatoren krijojnë një radhë lulesh/ çadrash duke iu vënë nga një numër secilës në mes. (Edukatoret të ndihmojnë fëmijët duke përdorur ilustrimet e punës në këtë material).</p> <p><b>Loja.</b> Lojë me rathë. Krijoni disa rathë me ngjyra në tokë, dhe vendosni nga një numër brenda tyre. Kërkojuni fëmijëve të hidhen në rathë sipas radhës.</p> <p><b>Këngë lëvizore:</b> “Një elefant po kolovitet”.</p>	<p>Manuali i Vjershave</p> 
<b>Premte</b>	<p>Dita e edukatores.</p> 	<p>Edukatoret mendojnë vetë për aktivitetet që do të organizojnë sot.</p> <hr/> <hr/> <hr/>	





**Tema mujore: Sportet dhe lojërat**

**Tema e javës: Përgatitimi Për Festën e 1 Qershorit.**



Java IV	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Kërcejmë dhe këndojmë 	<p><b>Vjersha:</b> “Më gëzon në Maj ti mua”.</p> <p><b>Lojë energjike:</b> me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja.</p> <p><b>Vjersha:</b> “1 Qershori”.</p> <p><b>Kënga</b> “1 Qershori”.</p> <p><b>Aktivitet:</b> “<i>Improvizojmë një shfaqje muzikore</i>” fëmijë të cilët këndojnë, i bien veglave muzikore, fëmijë që kërcejnë.</p>	Manuali i Vjershave. Mjete: Lodra me muzikë.
E Martë	Krijimi i kapeles 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatorja pyet fëmijët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Çfarë është Festa e 1 Qershorit?</li> <li>• Çfarë bëjnë fëmijët gjatë festës së 1 Qershorit?</li> </ul> <p>I tregon rreth festës së fëmijëve. I shpjegon se gjatë festës fëmijët do të recitojnë, luajnë dhe këndojnë.</p> <p><b>Vjersha:</b> “1 Qershori”.</p> <p><b>Kënga</b> “1 Qershori”.</p> <p><b>Punë dore:</b> <i>Kapelet e 1 Qershorit</i>. Me ndihmën e edukatores dhe me fletë kartoni fëmijët bëjnë kapele sipas ilustrimit në këtë material. (lejojini fëmijët të ngjisin në kapele rathët/figurat e prera më pare nga edukatorja).</p>	Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: fletë kartoni të bardha ose me ngjyra. 



<p><b>E Mërkurë</b></p>	<p>Pregatitim vjersha e këngë për Festën e 1 Qershorit</p>	<p><b>Vjersha:</b> “Dallëndyshja”.  <b>Përralla:</b> “3 fluturat”.  <b>Vjersha:</b> “1 Qershori”.  <b>Kënga</b> “1 Qershori”.</p> <p><b>Lojë ekuilibri dhe me shami:</b> Vizatoni disa vija të lakuara me forma të ndryshme në dyshe me oborr. Kërkojuni fëmijëve që të ecin sipas drejtimit të vijës dhe të kapin shaminë.</p>	<p>Manuali i Vjershave</p> 
<p><b>E Enjte</b></p>	<p>Pregatitim vjersha e këngë për Festën e 1 Qershorit</p> 	<p><b>Vjersha:</b> “Ora e qytetit”.  <b>Përralla:</b> “3 fluturat”.  <b>Vjersha:</b> “1 Qershori”.  <b>Kënga</b> “1 Qershori”.</p> <p><b>Ngjyrosje/Punë dore:</b> <i>Krijojmë kartolinat për 1 Qershorin.</i> Fëmijët ngjyrosin/bëjnë me punë dore lulet e pranverës si, luledielli, tulipanët, trëndafilat duke krijuar një kartolinë për shokun/shoqen e grupit.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike</p> 
<p><b>E Premte</b></p>	<p>Pregatitim vjersha e këngë për Festën e 1 Qershorit</p>  <p>Krijojmë pemën e grupit të fëmijëve</p>	<p><b>Vjersha:</b> “Ngjyrat e ylberit”.  <b>Improvizim i përrallës:</b> “3 fluturat”. Edukatorja ndihmon fëmijët të improvizojnë përrallën. Aktiviteti zhvillohet në oborr.  <b>Vjersha:</b> “1 Qershori”.  <b>Punë dore:</b> <i>Krijojmë pemën e grupit të fëmijëve.</i> Prindërit e fëmijëve sjellin me foto një objekt të preferuar të fëmijëve që e vënë krahas fotos së fëmijëve. Fëmijët prezantojnë veten përpara shokëve.  <b>Loja:</b> Lojëra energjike me shami.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike</p> 